

Tel: +355 4 22 69097 +355 4 22 69325 Fax: E-Mail: info@dpa.gov.al	Udhëzues për tranzicionin për SSH ISO 50003:2021	Kodi DA-IN-023
		Rishikim nr 0 Dt 21.02.2022
		Faqe 1-4

Udhëzues për kalimin nga standardi SSH ISO 50003:2014 në
SSH ISO 50003:2021

Zbatuesit: Staf i DPA-së, vlerësuesit teknik dhe organet certifikues të sistemeve të menaxhimit të energjisë

Përgjegjësi për zbatim: Drejtori i drejtorisë së organeve certifikuese dhe inspektuese

Kontrolloi: Ardita Mele

Miratoi: Armond HALEBI

<p>Tel: +355 4 22 69097 +355 4 22 69325 Fax: E-Mail: info@dpa.gov.al</p>	<p>Udhëzues për tranzicionin për SSH ISO 50003:2021</p>	<p>Kodi DA-IN-023</p> <hr/> <p>Rishikim nr 0 Dt 21.02.2022</p> <hr/> <p>Faqe 2-4</p>
---	--	---

1. QËLLIMI

Ky dokument përshkruan udhëzime për kalimin nga SSH ISO 50003:2014 në SSH ISO 50003:2021. Ky dokument është i vlefshëm për DPA dhe vlerësuesit e saj si dhe për organet certifikuese të sistemeve të menaxhimit të energjisë të akredituar nga DPA, organet certifikuese të sistemeve të menaxhimit të energjisë që kanë aplikuar për akreditim apo që kanë për qëllim të aplikojnë për akreditim. Ky dokument është i vlefshëm deri në datën 30 Nëntor 2023.

2. FUSHA E ZBATIMIT

Ky udhëzues zbatohet nga vlerësuesit dhe stafi i DPA, nga nënkontraktuesit e saj për vlerësimin e organeve certifikues që kryejnë certifikim të sistemeve të menaxhimit të energjisë në përputhje me këtë standard.

3. PËRGJEGJËSITË

Ky udhëzues është pjesë e sistemit të menaxhimit të DPA dhe si i tillë është nën përgjegjësinë e Drejtorit të Drejtorisë së Zhvillimit rishikimi i vazhdueshëm në varësi të ndryshimeve të duhura dhe përmirësimeve të vazhdueshme në sistemin e menaxhimit të DPA. Është detyrë e Drejtorit të Drejtorisë së organeve certifikuese dhe inspektuese të kontrollojë zbatimin e këtij udhëzimi.

4. REFERENCA

SSH ISO/IEC 17011:2017
IAF MD 24:2021 Kërkesat e tranzicionit të ISO 50003:2021

5. FJALORI DHE SHKURTIME

Në këtë udhëzues është përdorur terminologjia e standardit SSH ISO/IEC 17011:2017

IAF Forum Ndërkombëtar i Akreditimit

DPA Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit

6. PËRMBAJTJA

6.1. Të përgjithshme

Forumi Ndërkombëtar i Akreditimit ka vendosur një periudhë tranzitore 30 mujore për kalimin nga standardi SSH ISO 50003:2014 në standardin SSH ISO 50003:2021. Referuar dokumentit IAF MD 24:2021 periudha e tranzicionit për standardin SSH ISO 50003:2021 do të vazhdojë deri më datë 30 nëntor 2023. DPA do të kryejë vlerësime të tranzicionit për ISO 50003:2021 që nga data 28 Shkurt 2022

<p>Tel: +355 4 22 69097 +355 4 22 69325 Fax: E-Mail: info@dpa.gov.al</p>	<p>Udhëzues për tranzicionin për SSH ISO 50003:2021</p>	<p>Kodi DA-IN-023</p> <p>Rishikim nr 0 Dt 21.02.2022</p> <p>Faqe 3-4</p>
---	--	---

VEPRIMTARITË E CERTIFIKIMIT

6.2. Rekomandime për Organet e certifikimit

Rekomandohet që Organet e Certifikimit të:

- a) Planifikojnë dhe të përgatiten për të aplikuar tek DPA për tranzicionin dhe të bëhen gati për zbatimin e kërkesave të reja sipas afateve të përcaktuara në këtë udhëzim.
- b) Përfundojnë analizën e mangësive
- c) Zhvillojnë një plan tranzicioni duke përfshirë çështjet e mëposhtme:
 - identifikimin e ndryshimeve ndërmjet versionit të ri dhe atij të vjetër të standardit ISO 50003.
 - analizimin e impaktit të ndryshimeve në aktivitetet/proceset përkatëse dhe identifikimin e veprimeve të kërkuara për të siguruar përputhshmërinë me kërkesat e versionit të ri të standardit (psh. Sistemi i menaxhimit/dokumentat, IT, etj)
 - Zbatimin e veprimeve të kërkuara.
- d) Sigurojë që personeli përkatës janë kompetent sipas versionit të rishikuar dhe procesin e tranzicionit. Personeli mund të përfshijë, por jo të kufizohet tek: auditorët, rishikuesit e raporteve të auditimit, vendimmarrësit e certifikimit, rishikuesit e kontratës dhe planifikuesit.

6.3. Certifikimet e organizatave sipas standardit në fjalë

6.3.1. Certifikimet e reja dhe ricertifikimet:

Organet certifikuese duhet të përdorin versionin e ISO 50003:2021 për certifikim fillestar apo ricertifikim vetëm pas akreditimit të tyre sipas ISO 50003:2021.

6.3.2 Certifikimet e klientëve ekzistues

Organet certifikuese duhet të kenë përfunduar tranzicionin e të gjithë organizatave të certifikuara brenda datës 30 Nëntor 2023. Në versionin e ri të ISO 50003, përcaktimi i kohës së auditimit ka ndryshuar. Është e pranueshme që kontrata ndërmjet organizatës së certifikuar dhe organit certifikues të ndryshojë maksimumi në auditimin e parë të rivlerësimit, gjë që mund të ndodhë edhe pas datës 30 Nëntor 2023. Organizatat e certifikuara do të kenë impakt nga versioni i ri i ISO 50003:2021 në:

- Kërkesat e ndryshuara për përcaktimin e kohës së auditimit i cili mund të jetë i ndryshëm nga ai i përcaktuar në kontratën me organin certifikues
- Qasja e ndryshuar në lidhje me përmirësimin e performancës së energjisë.

VEPRIMTARITË E AKREDITIMIT

6.4. Kërkesa të reja për Akreditim

Duke nisur nga data **31 Maj 2022**, DPA do të përdorë versionin e ri të ISO 50003:2021 për vlerësimin e organeve certifikuese për akreditim fillestar. Duke filluar nga data 15 Mars 2022, DPA nuk pranon

<p>Tel: +355 4 22 69097 +355 4 22 69325 Fax: E-Mail: info@dpa.gov.al</p>	<p>Udhëzues për tranzicionin për SSH ISO 50003:2021</p>	<p>Kodi DA-IN-023</p> <hr/> <p>Rishikim nr 0 Dt 21.02.2022</p> <hr/> <p>Faqe 4-4</p>
---	--	---

më asnjë kërkesë të re për akreditim ose zgjerim të fushës së akreditimit, që i referohet standardit ISO 50003:2014. Nese ka patur aplikime te reja ose per zgjerim sipas ISO 50003:2014 deri në datën 15 Mars 2022 dhe vizita vlerësuese nuk është kryer deri në 31 Maj 2022, atëherë vizita vlerësuese do të kryhet sipas S SH ISO 50003:2021.

Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit do të jetë gati të vlerësojë sipas versionit të ri të ISO 50003 duke filluar që nga data 28 Shkurt 2022. Ajo do të trajtojë stafin e saj në përputhje me ISO 50003:2021 dhe procesin e tranzicionit.

6.5. Organet tashmë të akredituara sipas ISO 50003:2021 - menaxhimi i tranzicionit

Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit do të përfundojë tranzicionin e versionit të ri të ISO 50003 tek organet certifikuese të akredituara për certifikimin e sistemeve të menaxhimit të energjisë brenda datës 31 Maj 2023.

Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit do të shqyrtojë analizat e mangësive të cdo organi certifikues të akredituar sipas skemës së certifikimit ISO 50001:2018, planet e tranzicionit/zbatimit të ISO 50003, dokumentacionin e ndryshuar ku të reflektohen ndryshimet sipas versionit të ri të ISO 50003, evidenca të zbatimit të versionit të ri të ISO 50003 dhe cdo informacion tjetër që DPA mund tju kërkojë organeve certifikuese.

Nëse rezultati i vlerësimit të dokumentacionit është pozitiv (organi certifikues ka demonstruar plotësimin e kërkesave të versionit të ri të ISO 50003), DPA nuk organizon vizitë në zyrat e organit certifikues. Shqyrtimi i dokumentacionit nga ana e DPA do të llogaritet minimum një ditë pune dhe do të paguhet nga organi certifikues i akredituar

Nëse rezultati i vlerësimit të dokumentacionit nuk është pozitiv (organi certifikues nuk demonstron plotësimin e kërkesave të versionit të ri të ISO 50003), DPA organizon vizitë në zyrat e organit certifikues. Kohezgjatja e vizitës bazohet në analizën e riskut. Vlerësim me dëshmi nuk është i nevojshëm. Vizita në organin certifikues për vlerësimin e tranzicionit të ISO 50003 do të jetë gjatë vizitës mbikëqyrëse ose në një vizitë shtesë.